



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 30.01.2023, Nr. 09-111/01-5786



Në bazë të nenit 64 pika 1, 68 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Udhëzimit Administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtori për Arsim në Drenas, shpallë:

K O N K U R S

1. SHFMU "Shotë Galica", Abri e Epërme dhe SHFMU "Migjeni" Baicë.
-Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta
2. SHFMU "Naim Frashëri", Gllobar, SHFMU "Mehmet Gradica", Gradicë si dhe SHFMU "Regjep Gjeli", Likashan
-Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta
3. SHFMU "Bajram Curri", Nekoc dhe SHFMU "Shaban Polluzha" Korroticë e Epërme,
-Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta
4. SHFMU "Jusuf Gervalla", Negroc dhe SHFMU "Mehdi e Sylejman Bytyqi" Lagja Bytyq-Arllat
-Një asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta

Punët dhe detyrat për asistent/e për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, ndihmon në vendosjen në klasë dhe dorëzimi I fëmijes te personi familjar që e përcjell atë, në oborrin e shkollës.
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folurit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;

- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

Kushtet: Për vendet e punës, në këto nivele (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta) kandidatët duhet ta kenë të kryer drejtimi përkatës sipas Normativit 05/2021, shkolla e mesme dhe niveli i 5 –të (postsekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës-asistent do të bëhet në bazë të të Udhëzimit Administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin public. Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit administrativ nr. 05/2021 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin :

- Kopja e vërtetuar/e noterizuar e diplomës origjinale,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikata origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër se gjashtë(6) muaji
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni)
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr 10, 12
- Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm për një(1) institucion, gjegjësisht për një(1) pozitë në njëren prej pikave(1.2.3.4.5)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHT.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim. Rezultatet e konkursit do të shpallen në web-faqe të Komunës së Drenasit. Dokumentacioni nuk kthehet.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **01.03.2023 deri 15.03.2023.**

Njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen zyrtare të Komunës së Drenasit dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net>.

Drenas,
Më:30.01.2023

Drejtor për Arsim
Muhamet Gjoka

